

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA GLOGOC
MUNICIPAL GLOGOC
01 Nr. 400/01-22398
17/06/2025

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHENDETESIS- MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-4549
Nr. faqeve Br. stranica No. pages	- 2 -
Data: Datum: Date:	13, 06, 2025
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health

Marrëveshje mbi dhurimin

në mes Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës

dhe

Komuna e Glogocit

Palët me rastin e nënshkrimit përfaqësohen

Neni 1

1. Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, të cilën e përfaqëson Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm, në tekstin e metejmë (Dhuruesi) dhe
2. Komuna e Glogocit, në tekstin e metejshëm (Pranuesi) të cilin e përfaqëson Z. Ramiz Lladrovci.

Neni 2

Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i marrëveshjes është që Dhuruesi ja dhuron Pranuesit autoambulancën e re me pajisje përcjellëse për nevoja të shërbimeve shëndetësorë.

Neni 3

Obligimet e Ministrisë së Shëndetësisë

1. Dhuruesi obligohet që autoambulancën e re "OPEL" me numër të shamisë; VXEYCF8F4SG015131 t'ia dorëzojë Pranuesit me rastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje.
2. Dhuruesi, obligohet që autoambulancën e dhuruar të fshijë nga lista e pasurisë së Ministrisë së Shëndetësisë.

[Signature]

Neni 4
Obligimet e Pranuesit

1. Pranuesi obligohet që autoambulancën e pranuar nga Dhuruesi duhet ta përdorë vetëm për nevojat dhe aktivitetet e shërbimeve shëndetësore si dhe shërbime tjera sipas nevojës.
2. Pranuesi duhet të përkujdeset për të gjitha obligimet që rrjedhin lidhur me autoambulancën si: regjistrimi, servisimi si dhe mirëmbajtja funksionale e autoambulancës.
3. Pranuesi obligohet që autoambulancën e pranuar nga Dhuruesi ta regjistrojë në listën e pasurisë së K.K. Gllogoc.

Neni 5
Afati i dorëzimit

Dorëzimi i autoambulancës, objekt i kësaj marrëveshje, nga ana e dhuruesit do të bëhet menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes nga palët.

Neni 6
Kalimi i Pronësisë

Kalimi i pronësisë së autoambulancës, objekt i kësaj kontrate, do të bëhet menjëherë pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje nga të dy palët.

Neni 7
Zbatimi

Me nënshkrim të kësaj marrëveshje, palëve u lind detyrimi që ti përbahen obligimeve të përcaktuara, përndryshe pasojnë dispozitat e ligjit përkatës në fuqi të Republikës së Kosovës.

Neni 8
Hyrja ne fuqi

Marrëveshja nënshkruhet në tri kopje origjinale dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Prishtinë
12.06.2025

Ministria e Shëndetësisë
Dr. Naim Haxhiu, Sekretar i Përgjithshëm



Komuna e Gllogocit
Z. Ramiz Lladrovci, kryetar

